


INSTITUTI EPIK

PRILL 2019

IKJA E MADHE



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Në periudhën 2008-2018, gjithsej 203,330 qytetarë të Kosovës kanë ikur nga Kosova dhe kanë bërë kërkesë për azil në Bashkimin Evropian (BE). Gjatë kësaj kohe po ashtu, 141,330 qytetarë të Kosovës të u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE.

1/5 e popullatës së Kosovës kanë ikur nga Kosova

Sidoqoftë, që nga viti 2016, Kosova ka shënuar një rënie të konsiderueshme si në numrin e kërkesave për azil ashtu edhe në numrin e shtetasve të Kosovës që u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE. Në fakt, viti 2018 ka qenë vit më trend më të mirë në të dyja kategoritë.

Megjithatë, këto dy të dhëna përfaqësojnë 344,660 qytetarë të Kosovës të cilët kanë vendosur të ikin nga Kosova dhe të kërkojnë një jetë më të mirë në BE. Me fjalë të tjera, 1/5 e popullsisë së Kosovës ka ikur nga Kosova. Për më tepër, këto të dhëna janë edhe më dramatike nëse shtohet kësaj edhe numri i qytetarëve të Kosovës që kanë migruar në BE përmes rrugëve tjera ligjore, siç janë lejet e punës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Shkaqet kryesore të cilat shtyjnë qytetarët e Kosovës drejt vendimit për të ikur nga vendi gjinden në pakënaqësinë e qytetarëve me gjendjen politike dhe ekonomike në vend, si dhe pritjet e tyre pesimiste për të ardhmen e Kosovës.

Sipas pulsit të fundit publik të UNDP-së, 1/3 e të rinjve të Kosovës konsiderojnë se e ardhmja e Kosovës është në rrugën e gabuar.

73.5% e të rinjve nuk kanë ose kanë shumë pak pritje se do të gjejnë punë në gjashtë muajt e ardhshëm.

48% e të rinjve nuk besojnë që situata politike dhe ekonomike do të përmirësohet.

Në këtë kontekst, të rinjtë e shohin migrimin si alternativën e tyre të vetme.

58% e të rinjve do të konsideronin migrimin në tre vitet e ardhshme. Nga ana tjetër vetëm 17.9% nukdo ta konsideronin migrimin si opsion.

1/3 e të rinjve të Kosovës konsiderojnë se e ardhmja e Kosovës është në rrugën e gabuar

58% e të rinjve do të konsideronin migrimin në tre vitet e ardhshme

AZILKËRKUESIT NGA KOSOVA NË BE (2008-2018)



Në periudhën 2008-2018, gjithsej 203,330 qytetarë të Kosovës kanë bërë kërkesa për azil në BE, nga të cilët 171,695 ishin azilkërkues për herë të parë.

Destinacioni kryesor ishin: Gjermania (69,060), Hungaria (54,860), Franca (38,400), Belgjika (13,540) dhe Suedia (10,630).

Në vitin 2015, Kosova përjetoj rritje drastike të azilkërkueseve në BE, me numrin total prej 72,480 azilkërkues, prej të cilëve 66,885 ishin azilkërkuesit për herë të parë.


Që nga atëherë, Kosova shënoj rënie më të madhe të azilkërkueseve, nga 72,480 në vitin 2015, në 4,970 në 2018 – një rënie prej 93%. Njëkohësisht, numri i azilkërkuesve për herë të parë ka rënë nga 66,885 në 2015 në 3,300 në 2018.

**Në periudhën 2008-2018,
gjithsej 203,330 qytetarë të
Kosovës kanë kërkuar azil në
BE**

**Destinacioni kryesor ishin:
Gjermania, Hungaria, Franca,
Belgjika dhe Suedia**

AZILKËRKUESIT NGA KOSOVA NË BE (2008-2018)

BURIMI: EUROSTAT



QYTËTARËT E KOSOVËS ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM NË BE (2008-2018)



Në periudhën 2008-2018, gjithsej 141,330 qytetarë të Kosovës u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE. Këto të dhëna nuk përfshijnë të dhënat e vitit 2018 për Kroacinë, Italinë, Lituaninë, Holandën dhe Rumaninë - edhe pse ndikimi i tyre do të jetë marginal.

Vendet kryesore të BE ku qytetarët e Kosovës u gjetën ilegalisht të pranishëm ishin: Gjermania (46,600), Hungaria (63,070), Austria (9,195) dhe Franca (8,760).

Viti 2015 dhe 2016 shënuan rritje të ndjeshme të numrit të qytetarëve të Kosovës që u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE. Në vitin 2015, 33,785, ndërsa në vitin 2016, 50,040 qytetarë u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE.

Që atëherë, numri i shtetasve të Kosovës të gjetur ilegalisht të pranishëm në BE ka rënë në nivelin e dytë më të ulët të regjistruar ndonjëherë. Në vitin 2018, 4,205 qytetarë të Kosovës u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE.


Në periudhën 2008-2018, gjithsej 141,330 qytetarë të Kosovës u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE

Destinacioni kryesor ishin:
Gjermania, Hungaria, Austria
dhe Franca

QYTËTARËT E KOSOVËS ME QËNDRIM TË PALIGJSHËM NË BE (2008-2018)

BURIM: EUROSTAT

Numri i qytetarëve të Kosovës me qëndrim të paligjshëm në BE 2008-2018



IKJA E MADHE



Dy grupe të të dhënave që ne kemi analizuar në këtë hulumtim, na sjellin në një përfundim të zyrtë.

Që nga viti 2008, gjithsej 203,330 qytetarë të Kosovës kanë ikur nga Kosova dhe kanë aplikuar për azil në BE. Për më tepër, 141,330 qytetarë të Kosovës u gjetën ilegalisht të pranishëm në BE.

Këto dy të dhëna përfaqësojnë 344,660 qytetarë të Kosovës të cilët kanë vendosur të ikin nga Kosova dhe të kërkojnë një jetë më të mirë në BE. Me fjalë të tjera, 1/5 e popullsisë së Kosovës ka ikur nga Kosova. Për më tepër, këto të dhëna janë edhe më dramatike nëse shtohet kësaj edhe numri i qytetarëve të Kosovës që kanë migruar në BE përmes rrugëve tjera ligjore, siç janë lejet e punës.

Këto të dhëna kanë korrelacion të fortë me të dhënat e EUROSTAT-it mbi demografinë e Kosovës*. Në vitin 2008, Kosova kishte 2,153,139 qytetarë. Deri në vitin 2018, popullsia ka rënë në 1,798,506 - një rënie prej 354,633 qytetarëve, ose 16.5% të popullsisë së Kosovës të vitit 2018.


**Në periudhën 2008-2018,
344,660 qytetarë të
Kosovës, apo 1/5 e popullsisë
kanë vendosur të ikin nga
Kosova në kërkim të një jete
më të mirë në BE**

* Në vitin 2010, të dhënat për popullsinë e Kosovës ishin vlerësime. Në vitin 2011 dhe 2015 ka pasur një "break" në përfaqësimin e të dhënave, dhe të dhënat për vitin 2014 janë vlerësime.

IKJA E MADHE

BURIMI: EUROSTAT

Numri i qytetarëve të Kosovës me qëndrim të paligjshëm në BE +
Numri i azilkërkuësve nga Kosova në BE 2008-2018



IKJA E MADHE

Shkaqet kryesore të cilat shtyjnë qytetarët e Kosovës drejt vendimit për të ikur nga vendi gjinden në pakënaqësinë e qytetarëve me gjendjen politike dhe ekonomike në vend, si dhe pritjet e tyre pesimiste për të ardhmen e Kosovës.

Sipas pulsit të fundit publik të UNDP-së, 1/3 e të rinjve të Kosovës konsiderojnë se e ardhmja e Kosovës është në rrugën e gabuar. Nga ana tjetër vetëm 9.5% mendojnë se e ardhmja e Kosovës është në rrugën e duhur.

73.5% e të rinjve nuk kanë ose kanë shumë pak pritje se do të gjejnë punë në gjashtë muajt e ardhshëm. 48% e të rinjve nuk besojnë që situata politike dhe ekonomike do të përmirësohet. Të rinjtë konsiderojnë këto sfidat si pengesat për jetesë në Kosovë: mungesa e mundësive për punësim, (60.1%); varfëria (49.3%), dhe nepotizmi / korrupsioni (43.0%).

Në këtë kontekst, të rinjtë e shohin migrimin si alternativën e tyre të vetme. 58% e të rinjve do të konsideronin migrimin në tre vitet e ardhshme. Nga ana tjetër vetëm 17.9% nukdo ta konsideronin migrimin si opsion.

1/3 e të rinjve të Kosovës konsiderojnë se e ardhmja e Kosovës është në rrugën e gabuar

58% e të rinjve do të konsideronin migrimin në tre vitet e ardhshme

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.
TE GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA.

